



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 21.11.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fiknete Bejta-LDK, kryesuese, Arbër Vokrii-VV, Taulant Maxharraj-AAK, Mimoza Xhaka- Bllacaku-eksperte e jashtme.

Në mbledhje ishte prezent edhe Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Mungoi: Liridon Selmani-PDK.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fiknete Bejta, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Raportimi i drejtoreshës së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelina Sahiti;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja, konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Pika e dytë

Raportimi i drejtoreshës së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, znj. Adelina Sahiti.

Adelina Sahiti tha se si Drejtori e Mirëqenies Sociale kemi mbështetur 100 familje, raste sociale për ngrohje në vlerë prej 25.000 euro, 70 familje të komunitetit shumicë, shqiptar, dhe 30 prej tyre të komuniteteve tjera pakicë. Po ashtu kemi mbështetur financiarisht 21 lehonat,

pjesë e skemës sociale me shumën prej 10.500 euro e që do të vazhdojmë ti mbështesim edhe për vitin 2023. Këtë mbështetje financiare do ta zgjerojmë edhe tek nënat vetushqyese dhe disa kategori tjera më të ndjeshme.

Po ashtu kemi përmirësuar qasjen në objektin e Komunës për personat e verbër, për përdoruesit e shkopit të bardhë që ta kenë mundësinë më të lehtë që të qasen. Kemi zbritur nivelin e sportelit, një sportel është më i zbritur për përdoruesit e karrocës, kemi marrë edhe një printer brait, me alfabetin brait që të kenë mundësi që të gjitha aktet normative, dokumentet që derivojnë nga Kuvendi Komunal ti marrin e ti kenë në duart e tyre. Po ashtu do të vazhdojmë ta kemi në web faqen e Komunës interpretin, që personat e shurdhër në Komunën e Prishtinës mund të marrin informata dhe të njoftohen për çka do që ndodhë në Komunën e Prishtinës. I kemi mbështetur rreth 31 organizata të shoqërisë civile të cilat janë ofruese të shërbimeve sociale dhe profesionale për grupe të cënueshme në Komunën e Prishtinës me vlerë prej 300.000, euro, si dhe është vendimi për mbështetje financiare për gratë që janë viktima të dhunës në familje, që është menduar për një shumë prej 500 euro që të mbështesim një grua e cila ka pësuar dhunë në familje.

Mimoza Xhaka, shtroi pyetjen se, përkrahja prej 500 euro, vetëm një herë jepet, apo vetëm këtyre grave që janë në kuadër të institucioneve dhe kush i përzgjedh këto, si klasifikohen. Po ashtu kërkoi të dijë se sa është numri i lehonave që kanë aplikuar, dhe çfarë mbështetje kanë marrë.

Taulant Maxharraj, e falënderoi drejtoreshën për raportimin, me ç'rast ceku se, ne si komitet i ofrojmë ndihmën tonë, por duke pasur parasysh se është viti i parë, megjithatë atë çka keni bërë si drejtori është e mjaftueshme, duke e ditur se mirëqenia sociale jo veç në Prishtinë, po në tërë Kosovën është shumë e ulët.

Fiknete Bejta, falënderoi drejtoreshën për raportimin e dhënë, me ç'rast ceku se jam shumë e lumtur që po shoh rezultate të kësaj drejtorie dhe duke pasur parasysh mandatin e kaluar, më duket se kanë qenë neglizhent ata që kanë pas detyrë me u marr me këtë drejtori. Tani vërehen se ka shumë projekte që po ecin, që po janë në të mirën e mirëqenies sociale në qytet. Këto subvencione që janë shpërndarë, janë shumë transparente dhe nuk ka pas vërejtje në shpërndarjen e tyre. Po ashtu përgëzoj në fakt ekzekutivin e Komunës së Prishtinës në aspektin e transparencës të ekzekutimit i thirrjeve që nuk ka pas ndonjë vërejtje për ndonjë keqpërdorim, ka qenë gjithçka me procedurat transparente.

Kërkoi të dijë se vendimi për ndarjen e shumës prej 500 euro për gratë që kanë pësuar dhunë familjare, a është i kalkuluar mirë, kush ka me e ekzekutua, pra duhet dikush me konstatua se a ka me të vërtetë dhunë në familje, apo veç është për stimulim.

Po ashtu kemi ngritur disa shqetësime edhe në drejtoritë e tjera, si psh në Drejtorinë e Arsimit, ku qendra e edukimit jo formal, por edhe çerdhet me bazë në komunitet, këto qendra nuk kanë pasur raporte kthyes, kështu që ne kemi dhënë mjete, mirëpo në fund të vitit ne nuk po kemi as një bilanc të gjendjes që me ditë ku po shkojnë ato mjete. Lidhur me këtë kërkoi një sqarim nga drejtorja e drejtorisë përkatëse. Gjithashtu kërkoi të dijë se kur do të ndërtohet objekti i ri i QPS-së.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e komitetit, sqarime të nevojshme dha Adelina Sahiti, drejtore.

Pika e tretë Të ndryshme

Arbër Vokrri

A ka një vlerësim të saktë për listën e njerëzve që kanë nevojë për ndihma sociale, ku këtë çështje veç e kam ngritur në mbledhjen paraprake, se ka dy tri raste që nuk besoj që janë të listuar diku. A kanë far vlerësimi, a duhet me dalë në teren, apo ndoshta ata vet duhet të lajmërohen.

Fiknete Bejta tha se në listën e rasteve sociale gjithmonë kemi has në një paradoks p.sh mundet me qenë një familje komplet pa punë, mirëpo nëse e ka trashëguar një parcelë nga gjyshi apo stërgjyshi, një parcelë që s'ka asnjë vlerë që mundet me u kthye në të mira materiale, e stopon, e përjashton prej listës sociale, ose brenda familjes nëse një pensionist qenka që merr të hyra edhe ai detyrimisht përjashtohet. Mendoj se kjo çështje nuk qëndron, dhe ne duhet të mendojmë se si ta ndryshojmë këtë kriter, por mendoj se kjo çështje nuk mund të rregullohet në nivel komunal.

Taulant Maxharraj tha se kjo është në kuadër të Ministrisë, e përcakton Ministria e Mirëqenies Sociale dhe për ndryshimin e ligjit mendoj se asociacioni mundet me e iniciuar nëse e kanë vullnetin, se është normal që duhet të ndryshohet.

Fiknete Bejta tha se ne mund të bëjmë presion që me u amendamentua ligji, me u formua një komision i mundshëm në kuadër të drejtorive përkatëse, për inicimin e ndryshimit të disa kriterëve.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

**Procesmbajtësja
Zijadin Gashi**

**Kryesuesja e komitetit
Fiknete Bejta**

